



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Komuna e Lipjanit: datë, 11/11/2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 09/11/2020 të parashtruar nga i Grupi i operatorëve ekonomik “IDEA EET” Sh.p.k, Duhël Suharekë me perfaqësues Avni Elshani lidhur me aktivitetin e prokurimit: **Furnizimi me dezinfektues 500ml (me bazë alkooli me efekt antibakterial 99.9%) dhe furnizimi me maska shumë përdorimshe për të gjitha Institucionet Edukativo-Arsimore. me nr te prokurimit 613-20-5228-121** nxjerr këtë ;

VENDIM

Refuzohet si e pa e bazuar kërkesa për rishqyrtim, e parashtruar nga Grupi i Operatorëve ekonomik “IDEA EET” Sh.p.k, Duhël Suharekë me perfaqësues Avni Elshani për aktivitetin e prokurimit: **Furnizimi me dezinfektues 500ml (me bazë alkooli me efekt antibakterial 99.9%) dhe furnizimi me maska shumë përdorimshe për të gjitha Institucionet Edukativo-Arsimore. me nr te prokurimit 613-20-5228-121** ,

Vendimi i AK për dhënien e kontratës të publikuar me datë: 06/11/2020 mbetet në fuqi dhe vazhdon me procedura të mëtutjeshme.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Grupi i Operatorëve ekonomik “IDEA EET” Sh.p.k, Duhël Suharekë me perfaqësues Avni Elshani për aktivitetin e prokurimit: **Furnizimi me dezinfektues 500ml (me bazë alkooli me efekt antibakterial 99.9%) dhe furnizimi me maska shumë përdorimshe për të gjitha Institucionet Edukativo-Arsimore. me nr te prokurimit 613-20-5228-121, me datë**

09/11/2020, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e lartëpërmendur. Autoriteti Kontraktues, me datë 10/11/2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:


Oferta juaj është refuzuar sepse me datë 30 tetor 2020 ju kemi dërguar letren për sqarim për çmimet që keni ofertuar, që kanë qenë tepër të ulta për artikujt që i kemi kërkuar, ju jeni përgjigjur se i rrini prapa çmimit të ofertuar siq edhe e keni cekë në kërkesën për rishqyrtim, por komisionin e vlerësimit nuk e keni bindur dhe ka kërkuar mostrat për artikujt që do të furnizoni. Pas marrjes së mostrave nga ana e komisionit konstatohet se artikujt që i keni ofruar për mostra nuk i plotësojnë kriteret e specifikimeve teknike të paraqitura në dosje të tenderit, ju keni ofruar maska që nuk janë as përafërsisht me karakteristikat e kërkuara andaj oferta juaj është refuzuar. Njashtu edhe dezinfektuesi me bazë alkooli nuk e ka përmbajtjen që është specifikuar në dosje të tenderit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi të këtij vendimi.**

Adem Duriqi



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit